NJOFTIM

ERE miraton rregullat për njoftimin dhe regjistrimin e operatorëve të impianteve të depozitimit të energjisë

Më datë 18.08.2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi rregullat për njoftimin dhe regjistrimin e operatorëve të impianteve të depozitimit të energjisë, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Rregullat përcaktojnë procedurën e njoftimit dhe regjistrimit, informacionin dhe dokumentacionin që duhet të paraqitet, si dhe mënyrën e administrimit të të dhënave në Regjistrin e Impianteve të Depozitimit të Energjisë.

📄 Në kuadër të kësaj procedure, ERE ka miratuar edhe formularët përkatës për njoftimin dhe regjistrimin, të cilët do të përdoren nga subjektet që i nënshtrohen këtij detyrimi.

📌 **Për subjektet që kanë njoftuar më parë pranë ERE-së**

Subjektet që, përpara hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, kanë njoftuar ose kanë paraqitur pranë ERE-së të dhëna për një impiant apo njësi të depozitimit të energjisë në kuadër të një aplikimi për licencim, ndryshim/modifikim licence apo procedure administrative, nuk do të duhet të riparaqesin të njëjtin informacion, kur të dhënat dhe dokumentacioni ekzistues në dosjen e tyre janë të mjaftueshme për regjistrim.

Kjo vlen edhe kur njësia e depozitimit është deklaruar si pjesë e projektit energjetik, përfshirë rastet kur është paraqitur si vepër ndihmëse, njësi depozitimi e integruar ose pjesë funksionale e impiantit të prodhimit të energjisë elektrike.

Në këto raste, ERE do të marrë në konsideratë dokumentacionin e administruar në dosjen përkatëse për qëllime të regjistrimit, duke shmangur riparaqitjen e dokumentacionit të depozituar më parë.

ℹ Për më shumë informacion mbi rregullat, formularët dhe procedurën e regjistrimit, referojuni materialeve të publikuara nga ERE.